


**SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE E  
TUBERKULOZIT NË SHQIPËRI  
GJATE vitit 2022**



*PRILL 2023*



## VËSHTRIM MBI EPIDEMIOLOGJINË E TUBERKULOZIT

Shqipëria edhe gjatë vitit 2022 bazuar në numrin e rasteve të reja me TB konsiderohet si vend më incidencë të ulët (**10.5 raste të reja për 100,000 banorë**), rezistencë të ulët baktëriale (0.2 %), mortalitetin e ulët (rreth 0.4 për 100,000 banorë) dhe rezultate të suksesit të mjekimit të larta 89%.

Gjatë vitit 2022 janë raportuar 292 raste me TB nga të cilat 264 (90.4 %) raste të reja dhe 28 raste (9.6 %) të ritrajuara. Krahasuar me vitin 2021 kemi një rritje të numrit të rasteve të ritrajuara më parë me 6.6%.

Raste e ritrajuara përshijnë: recidivë 27 (9.55%), ndërprerë, 1(0.5%). Arsyeja e ndërprerë është se pacienti ka patur mbivendojse diagnoze ( Ca pulmoni).

Grupmoshat më të prekura janë 15-24 vjeç 13.7 % , 25-34 vjeç (16.1% ), 55-64 vjeç (13%) dhe mbi 65 vjeç (32.9%) .

Rastet me TB në grupmoshen 15-24 vjeç gjatë vitit 2022 janë ulur me 5.6 %

Rastet me TB me moshë mbi 65 vjeç gjatë vitit 2022, është rritur me 10 % krahasuar me vitin 2021. Gjatë vitit 2022 rastet me TB në grupmoshat 25-34 dhe 55-64 vjeç vazhdojnë të jenë në shifra të njëjta.

Raste pulmonarë në total janë 246 (84.2 %) dhe raste ekstrapulmonarë në total janë 46 (15.8%). Krahasuar me vitin 2021 vihet re rritje e rasteve pulmonare 4%.

Raporti i të sëmurëve TB sipas vendbanimit, në fshat apo në qytet, po ndryshon vazhdimisht në favor të qytetit. Gjatë vitit 2022 rreth 211 ose 72.3% e pacientëve me TB banojnë në zonat urbane, ndërsa 81 ose 27.7 % banojnë në zonat rurale. Krahasuar me vitin 2021 rastet në qytet janë rritur me 5%.

Grupet e riskut zënë rreth 26 raste ose 9 % të rasteve me Tuberkuloz, kryesisht 10 emigrant, 12 të alkolizuar, 1 pacientë me HIV, dhe 3 raste nga popullata Rome dhe egjiptiane.


- Rastet me TB të testuar për HIV /AIDS janë rreth 90% e pacientëve me Tuberkuloz ku ka rezultuar vetëm 1 pacient me co-infeksion TB/HIV. Në rritjen e testimit të

pacienteve me TB një rol shumë të rëndësishëm ka dhe projekti i Fondit Global me sigurimin e testeve të shpejta për testimin e pacientëve me TB në çdo dispanseri të rrethit. Personeli i dispanserisë është trajnuar për kryerjen e testit të shpejt të HIV, nga stafi i Programit Kombëtar të HIV.


- 30 raste TB ose 10.3 % janë zbuluar gjatë kontrollit në vatër të familjes së pacienteve me TB.
- Raste me resistencë nga medikamentet tuberkulare janë 5 pacientë ose 0.2% krahasuar me totalin e rasteve TB.
- Në lidhje me rezultatet e ekzaminimit bakteriologjik për vitin 2022, të gjitha rastet pulmonare janë me konfirmim bakteriologjik të mikroskopisë direkte dhe testimin me rapid test Genexpert, të testuar pranë Laboratorit të Referencës së TB-së. Për të bërë të mundur zbulimin në kohë të Tuberkulozit në të gjithë vendin është forcuar sistemi i transporti të mostrave të sputumit TB, nga niveli lokal në nivel qendror.
- Shpërndarja më e madhe e rasteve me TB, është kryesisht në rrethin e Tiranës, Durrësit, Dibrës, Kukësit, Shkodrës, Lezhës dhe Lushnjës dhe më pak në rrethet e tjera. Arsyeja është migrimi që ndodh brenda vendit, me një fluks të madh të popullsisë rurale që shpërngulet në qytete të mëdha, sidomos në qytetin e Tiranës.

Shqipëria po i afrohet shumë qëllimit të saj për eliminimin e TB-së. Edhe pse ende ka një rrugë të gjatë përpara, vendi tashmë ka një qasje të mirë tek shërbimet, me rezultate të mira trajtimi të tuberkulozit të ndjeshëm ndaj medikamentit, me një normë të përfundimit të terapisë mbi 89% tek rastet e diagnostikuara dhe të trajtuara.

*Grafiku 1. Shpërndarja e rasteve me TB në vite*




Grafiku 2. Incidenca e rasteve të konfirmuara me TB sipas viteve (2008-2022)



Pavarësisht treguesve të mësipërm duhet theksuar se impakti i COVID-19 gjatë vitit 2020, 2021 dhe 2022, ka ndikuar ndjeshëm në uljen e numrit të rasteve me TB me një mesatare rreth 35 % krahasuar me vitin 2019. Ulja e numrit të rasteve me TB gjatë kohës së pandemisë është në nivel global. Pandemia e COVID-19 ka shkaktuar ndryshime thelbësore në kujdesin ndaj TB. Pacientët me tuberkuloz të diagnostikuar gjatë pandemisë COVID-19 shfaqën forma më të zgjatura pulmonare. Rritja e rasteve me TB aktive në pacientë me grupmoshë aktive mund të reflektojë rritjen e transmetimit të TB-së në popullatë.

Grafiku 3: Klasifikimi i rasteve TB (Raste të reja dhe të përsëritura )




Grupmoshat më të prekura janë: 0-14 vjeç (2.1%), 15-24 vjeç (13.7%), 25-34 vjeç (16%), 35-44 vjeç (9.6%), 45-54 vjeç (12.7%), 55-64 vjeç (13%) dhe mbi 65 vjeç (32.9%). Vihet re që, gjatë vitit 2022 tuberkulozi është më i shprehur në moshat aktive të popullatës, e kryesisht në moshën 24-34 vjeç. Grupmosha mbi 65 vjeç gjatë vitit 2022 është rritur me 10 %, krahasuar me vitin 2021.

Pacientet TB sipas gjinisë janë: meshkuj 203 (69.5%) dhe femra 89 (30.5%). Raporti meshkuj/femra në lidhje me TB e të gjitha formave, vazhdon të jetë 2:1 në favor të meshkujve. Gjatë vitit 2022 vihet re një rritje me rreth 5% në meshkuj krahasuar me vitin 2021.


Përsa i përket formave të tuberkulozit gjatë vitit 2022 janë 246 (84.2%), raste pulmonare dhe 46 (15.8%) raste ekstrapulmonare. Gjatë vitit 2020, 2021 dhe 2022 është konstatuar se, për shkak dhe të pandemisë COVID-19, numri në total i rasteve me TB ka patur rënie. Në totalin e rasteve me TB, format pulmonare kanë pësuar një rritje krahas formave ekstrapulmonare të TB-së. Krahasuar me vitin 2021 vihet re rritje e rasteve pulmonare me 4%.

*Grafiku 4. Shpërndarja e rasteve sipas formave të sëmundjes së TB në vite, 2013-2022.*




Gjatë vitit 2022 rreth 98.3% e rasteve me TB pulmonare, janë të konfirmuar me ekzaminim bakteriologjik (sputum dhe rapid test Genexpert).

Grafiku 5: Egzaminimet laboratorike në Laboratorin e References së TB në SUSHN



Grafiku 6: Mostra e marrë kundrejt kulturave pozitive TB

## Samples received vs positive cultures 2017-2022



Sic shihet dhe nga grafiku, kemi nje rritje me rreth 60% të ekzaminimeve laboratorike për diagnozën e TB-së, kryer në Laboratorin e Referencës së TB për vitin 2022 krahasuar me vitin 2021. Kjo rritje ka ardhur si pasojë e funksionimit të sistemit të transportit të suptumit nga NJVKSH-të e rretheve në SUShN, ku koordinimi i tyre është kryer nga Programi Kombëtar i Tubekulozit, pranë Insitutit të Shëndetit Publik.

- ✓ **Tuberkulozi është sëmundje plotesisht e shërueshme.**
- ✓ **Tuberkulozi është plotësisht i parandalueshëm**
- ✓ **Diagnostikimi dhe trajtimi janë falas dhe në dispozicion, në të tri nivelet e kujdesit shëndetësor në vend**